



KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 999 Prot.

Vlorë, më 22.01. 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ datë ____ 2025

**“PËR MIRATIMIN E SHESHIT “FLAMURTARI” NË TERRITORIN E
BASHKISË VLORE”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 8, neni 9.1, pika 1.1/a dhe b, pika 1.7/b, neni 54 pika ll; me propozim të kërkeses nr 19394 prot , datë 03.12.2024 , të ish – futbollisteve të ekipit “ Flamurtari “ të miratuar nga Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë me Vendimin Nr. 1 datë 21/01/2025, si dhe në relacionin e paraqitur nga Sekretariati i Këshillit të Bashkisë së bashku me dokumentacionin shoqërues, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 28/01/2025

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e sheshit “FLAMURTARI” në lagjen 10 Korriku, Rajoni 2, pranë Stadiumit “Flamurtari”, sipas planvendosjes së përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij Projektvendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

KRYETAR
Elpiniq Mërkuri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

Nr. 999 prot.

Vlorë, më 22.01 2025

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN PËR “EMËRTIM SHESHI NË QYTET ME EMRIN “FLAMURTARI”

PARA KESHILLIT TË BASHKISË

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-Vendimi PËR “EMËRTIM SHESHI NË QYTET ME EMRIN “FLAMURTARI” që po ju paraqesim ka për qëllim miratimin në kuadër të vlerësimit të Ekipt të Flamurtarit si një ndër ekipet më të vlerësuara në Shqipëri. Themeluar në vitin 1923, Flamurtari është një nga klubet më të vjetra shqiptare, dhe gjithashtu është një nga klubet më të suksesshme shqiptare, duke fituar titullin e Kategorisë Superiore një herë në vitin 1991, gjithashtu katër herë Kupën e Shqipërisë dhe dy herë Superkupën e Shqipërisë.

Flamurtari është i njohur gjithashtu për fushatat e tij evropiane në vitet '80, ku ata shkruan historinë e futbollit shqiptar, duke arritur në gjashtëmbëdhjetë më të mirët e 1987–88 UEFA Cup, ku ata mposhtën gjigantët spanjollë të Barcelonës, por u eliminuan nga rezultati i përgjithshëm.

Fillimet e ndeshjeve me të huajt vlonjatët, thuhet dhe dokumentohet, t'i kenë luajtur rreth vitit 1918, me marinarë të huaj që zbrisnin nga porti i Skelës drejt qendrës së qytetit. Kurse pas organizimit në shoqatë sportive, futbollit vlonjat, nga viti 1925 deri në vitin 1937, ka zhvilluar rreth 10 takime. Kryesisht në gadishullin e Ballkanit, por edhe me futbollistë të Italisë.

Ndeshjen e parë ndërkombëtare zyrtare e ka zhvilluar në Athinë, me ekipin e AEK-ut, për Kupën Ballkanike, në vitin 1980.

Pra, majat më të larta të cilësisë, mbresat e shkëlqyera të futbollit vlonjat janë në vitet 1980-1990, kur “Flamurtari” hodhi hapin e parë jashtë vendit, për t'u ballafaquar me futbollin ballkanik dhe atë evropian.

Veçanërisht në vitin 1987, kur vlonjatët takohen për herë të dytë me futbollistët spanjollë të “Barcelonës” dhe largohen nga kupa UEFA në tur të tretë, gjë që s’e kishte arrirë me parë ndonjë ekip shqiptar.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri







BASHKIA VLORË

DREJTORIA E
URBANISTIKËS

Miratoi
Dr. Klaudio Mehmetaj

PLANVENDOSJE PËR EMËRTIMIN E SHESHIT "FLAMURTARI"
NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË.



BASHKIA VLORE

DREJTORIA E
URBANISTIKES

MIRATOI
KLAUDIO MEHMETAJ

Konceptoi Ark. Orges Deraj

VENDODHJA

PLANVENDOSJE PËR EMËRTIMIN E SHESHIT "FLAMURTARI" NË TERRITORIN E BASHKISË VLORE.

VLORE 2024

A-01